

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI JURIDIK

MASTER - PENAL



PUNIM DIPLOME MASTER

**“AKTGJYKIMI LIRUES NË GJYKATËN THEMELORE NË PRISHTINË GJATË
PERIUdhËS 2016-2020”**

Mentori:

Prof. Dr. Azem Hajdari

Kandidatja:

B.Sc. Elsa Idrizi

Prishtinë, 2024

ABSTRAKT

Gjykata Themelore në Prishtinë, Divizioni Penal, përgjatë punës së saj nga krijimi e në vazhdimësi ka nxjerr një numër të madh të aktgjykimeve duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës. Një numër të madh të këtyre aktgjykimeve e përbëjnë edhe aktgjykimet liruese, aktgjykime këto të cilat e lirojnë të pandehurin nga akuza e cila është ngritur nga ana e Prokurorisë së Shtetit.

E drejta e të pandehurit për një gjykim të drejtë dhe të paanshwm, si dhe marrja e vendimit duke u bazuar në provat dhe deklaratimet e dëshmitarëve, ekspertëve e personve të tjerë relevant në procedurë, është një e drejtë që iu garantohet me aktin më të lartë juridik – Kushtetuten e Republikës së Kosovës si dhe ligjet tjera në kuadër të fushës penale si: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës etj.

Gjatë hulumtimit për vendosjen e temës ka qenë mjaft interesante ndërlidhja e arsyetimeve të gjyqëtarëve të ceshtjes deri në arrijten e nxjerrjes së një aktgjykimi lirues. Me rastin e analizimit të rasteve nga praktika gjyqësore e Gjykates Themelore në Prishtinë do të vërejmë detaje të shumta e të cilat shume shpesh edhe mund të na ikin. Këto detaje e bëjnë mjaft të vështirë provimin e pafajësisë së një të pandehuri, pasi që kundërgumetimi i provave që adminsitrohen gjatë procedurës lexohen në shumicën e rasteve me vetë faktin që të vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Andaj, gjatë shqyrtimit të kësaj periudhe do të vërehet efikasiteti i gjykatës për garantimin e të drejtave themelore të njeriut, të garantuara si me ligjet e RKS-së ashtu edhe me ato ndërkombëtare.

Do të shtjellohen bazat ligjore në vendimmarrjen e një aktgjykimi lirues si dhe në thellësi do të vërehet pesha e secilës provë dhe palë në procedurë. Fokusi do të jetë në praktikën e Gjykatën Themelore të Prishtinës kryesisht në periudhën 2016-2020, ku do të vërejmë bazat e ndryshme në të cilat është vendosur aktgjykimi.

Fjalwt kyçe: Aktgjykimi lirues, Shqiptimi, Pwripilimi, Kodi Penal i Republikws sw Kosovws , vëllimi dhe dinamika e aktgjykimeve liruese